

## **AKT THEMELIMI**

### **I SHOQERISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

#### **"KLEA & INA SH.P.K"**

Mbështetur në kushtetutën dhe Kodin Civil në Shqipëri, bazuar në Ligjin Nr.9901, date

Nr.10 475, date 27.10.2011 Per nje ndryshim ne Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 PER TREGTARET DHE SHOQERITE TREGTARE '' DHE LIGJIT Nr.9723, date 03.05.2007 per Q.K.B te nenshkruarit: Klea Bali e bija e Arjan, e datelindjes 05.12.1996, lindur në Belsh qarkut te Elbasanit, mbajtese ID me nr J66205011E, si edhe Dafina Allaraj e bija e Rahman i datelindjes 14.10.1992 mbajtese ID me nr J26014040G lindur ne Tirane, me vullnetin tone të lirë,të shprehur edhe në nëshkrimin e këtij akt-themelimi sot vendosim të krijojm shoqërinë tregtare me përgjithësi të kufizuar "KLEA & INA" sh.p.k me akt themelimi si vijon:

#### **Formulimi**

##### **Neni 1**

Formohet shoqëria private e quajtur "KLEA & INA" sh.p.k do të ketë selinë në Mezez Zona Kadastrale Nr. 2679 Volum 22 fq. 36 Nr I pasurisë 53190 të qytetit të Tirane

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë , të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqiperise , vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakeve .

#### **Objektivi I Veprimtarisë**

##### **Neni 2**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e: Konsulence ekonomike dhe juridike,studime te tregut dhe trajnime.

### **Neni 3**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jete me nje afat 20-vjeçar . Afati I veprimtarisë së shoqërisë, mund të ndryshojë, me vendim të shoqërisë.

### **Kapitali I Shoqërisë**

#### **Neni 4**

Kapitali fillestar I shoqërisë private “KLEA & INA” sh.p.k do të jetë 100.000 (njëqind mijë lekë ). Kapitali është 100% i ndarë në 2 kuota nga 50% secili ortak . Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet ose të pakësohet ( por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar ).

### **Drejtimi I Shoqërisë**

#### **Neni 5**

Shoqëria do të drejtohet nga administratoret e saj. Ata jane përfaqesuesit e Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe kane kompetenca të plota në drejtimin e saj .

Çdo kontratë do të kryhet prej tyre dhe ne rast mungesë nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme .

#### **Neni 6**

Fitimi që do të rezultoje nga veprimtaria e shoqërisë i takon i ndare ne dy kuota, nje kuote secili. Shoqëria nuk përgjigjet për humbjet e ortakut të saj jashtë veprimtarisë së shoqërisë.

#### **Neni 7**

Ortaket e shoqërisë kane te drejtë të emërojnë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale. Kane te drejtë te caktojnë financiarë , likuidator për problemet e shoqërisë si dhe të pajtojnë persona të tjerë,si ortakë .

#### **Neni 8**

Konfliktet që mund te lindin do të zgjidhen në zbatim te legjislacionit Shqipëtar në Gjykatën e Rethit Gjyqësor Tiranë .

#### **Neni 9**


Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë te normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi .

**Neni 10**

Akti I themelimit u përpilua në 4 kopje , për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “KLEA & INA” sh.p.k  
Akti I themelimit nënshkruhet rregullisht nga dy ortakët.

**Ortakët themelues të  
“KLEA & INA” sh.p.k**

Klea Bali 

Dajna Allorgj 

26/06/2019

